REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKES
THE MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
05 NR.1177
Datë : 28.06.2021

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria komunale e Arsimit shpall

KONKURS
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2021/2022

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.
Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2.Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
Ekstraktin e lindjes.

3.Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2021/2022, bëhet më datën 28, 29,30 qershor 2021 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.
Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 01.07.2021.
Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 02.07.2021.
Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A.Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar	**(40%)**	**40 pikë**
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test	**(20%)**	**20 pikë**
3. Numri i pikëve nga testi	**(40%)**	**40 pikë**

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë **100** pikë.

Gjimnazi " Jeta e re "- Suharekë

Nr.	Drejtimi	Nr.paraleve	Nx.në paralele	Gjithsej
1.	Gjimnazi shkenca natyrore	6	24	144
2.	Gjimnazi shkenca shoqërore	6	24	144
Gjithsej		12	24	288

Shkolla e mesme teknike"Skender Luarasi"- Suharekë

Nr	LËMI MËSIMOR	PROFILI MËSIMOR	Nr.paraleleve	Nr. i nxenesve
1	*ELEKTROTEKNIKË*	Teknik i sistemeve të IT-së	1	24
		Teknik i informatikës së bizneseve	1	24
		Instalues elektrik	1	24
2	*MAKINERI*	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujesjellesit	1	24
		Automekanik	1	24
		Metalpunues	1	24
3	*TEKSTIL*	Rrobaqepësi	1	24
	NDËRTIMTARI	Arkitekturë	1	24
		Ndertimtari	1	24
		Gjeodezi	1	24
	TOTAL		10	240

Shkolla profesionale „Abdyl Ramaj"- Shirokë

Nr	LËMI MËSIMOR	PROFILI MËSIMOR	Nr.paraleleve	Nr. i nxenesve
1	*EKONOMI*	Kontabilist dhe tatime	1	24
		Marketing	1	24
		Tregti me pakicë dhe shumicë	1	24
		Banka dhe sigurime	1	24
2	*ADMINISTRATË*	Asistent juridik	1	24
		Asistent administrate	1	24
3	*KIMI - TEKNOLOGJI*	Laborant i kimisë	1	24
		Teknologjia e materialit të ndërtimit	1	24
	HOTELIERI DHE TURIZËM	Asistent hotelerie(restoranti)	1	24
4	*TEKNOLOGJIA USHQIMORE*	Teknologjia ushqimore	1	24
5	*BUJQËSI*	Hortikulturë	1	24
		Agrobiznes	1	24
	TOTAL		**12**	**288**

Drejtoria e Arsimit
Renazi Bajselmani